



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 1100/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Ramadan Dema kandidat për asamblenë komunale në Kaçanik nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)-Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2012, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**MIRATOHET** si e bazuar ankesa e Ramadan Dema kandidat për asamblenë komunale në Kaçanik nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK),

**URDHËROHET** KQZ që të rinumëroj fletëvotimet në Vendvotimet 0701X/08D dhe ky numërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

#### **A R S Y E T I M**

PZAP-i me datën 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Ramadan Dema kandidat për asamblenë komunale në Kaçanik nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën pretendon se në VV 0701X/08D ka ndodhur një lëshim teknik nga ana e kryesuesit të VV ku PDK ka pasur 127 vota ndërsa parashtruesi i ankesës 23 vota të cilat nuk janë procesuar fare në FRK, dhe këtë e dëshmojnë vëzhguesit dhe komisionarët e tyre.

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit gjeti se:

- **ankesa është e bazuar**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga hetimi i bërë në QNR ka vërejtur se ka pasur parregullsi pasi që gjatë hetimit të bërë në QNR, në QV

0701X/08d janë 127 vota për subjektin politik PDK ndërsa në FRK nuk figurojnë asnjë votë andaj urdhërojmë që të bëhet rinumërimi në këtë VV. Andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotimeve. Andaj PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
A nr. 1100/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



**Këshillë Juridik:**

*Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i*